

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM***Nr. 101, Datë 04.07.2017***MBI****FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“M.T.C ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË BANKËS “RAFFEISEN BANK” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licensuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k, për lënie peng asetesh në favor të Bankës “Raffaisen Bank” sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Asetëve nga të Licensuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gërmat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licensuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licensuar); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licensuar pas kryerjes së transferimit);

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me gërmën “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit

të aseteve); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licencuar), të pikës 1 të nenit 7, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy“ sh.p.k, për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Raffaisen Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI